



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 31 mars 2011
Nr. ref.: AGJ 109/11

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KI 25/10

Parashtruesi

Agjencia Kosovare e Privatizimit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës
Supreme të Kosovës, ASC-09-089, të 4 shkurtit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtrues është Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), e përfaqësuar nga drejtori i Departamentit Ligjor të AKP-së.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi gjyqësor i kontestuar është vendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme), ASC-09-089, i 4 shkurtit 2010, që parashtruesit i është dorëzuar më 10 shkurt 2010.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) i kushtetutshmërisë së vendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), me të cilin e refuzoi kërkesën e parashtruesit për ndryshimin e vendimit të Trupit Gjyqësor të Dhomës së Posaçme, sipas të cilit ripublikimi i listës së re të punëtorëve me të drejta në të ardhurat nga privatizimi është i panevojshëm.

4. Parashtruesi ankohet se:

- AKP ka të drejtë peticioni ndaj kësaj kërkesë në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës;
- Vendimet dhe aktgjykimet e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme janë objekt i shqyrtimit të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese;
- Kolegji i Apelit shkeli të drejtën e AKP-së për gjykim nga një gjykatë e pavarur, kur kërkoi sqarim nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të UNMIK-ut (në tekstin e mëtejme: PSSP);
- Kolegji i Apelit shkeli të drejtën e AKP-së për gjykim të paanshëm duke kërkuar sqarim nga PSSP-ja, duke qenë plotësisht në dijeni që UNMIK-u kishte interes të qartë dhe të konsiderueshëm në çështjen në fjalë;
- Kolegji i Apelit shkeli të drejtën e AKP-së për gjykim të ndershëm në bazë të parimit të barazisë para ligjit dhe qasjes së barabartë në gjykatë duke mos i ofruar AKP-së mundësinë për t'u përgjigjur lidhur me këtë sqarim;
- Kolegji i Apelit shkeli të drejtën e AKP-së për zgjidhjen e rastit duke u bazuar në Kushtetutë dhe ligj, kur refuzoi ta njihte Ligjin për AKP-në si ligj;
- Kolegji i Apelit nuk ka kompetencë të nxjerrë vendim që, në fakt, e zhvlerëson statusin e ligjit të Ligjit për AKP-në;
- Kolegji i Apelit e shkeli Kushtetutën, Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, dhe Rregulloren e Dhomës së Posaçme, kur ka marrë vendimin e nënshkruar nga katër gjyqtarë të EULEX-it;
- Letrat e UNMIK-ut dërguar gjykatave të Kosovës janë përpjekje të papranueshme e UNMIK-ut për të ndërhyrë në punën e gjyqësorit;
- Gjyqtarët e EULEX-it, të cilët e nënshkruan dhe nxorën Vendimin e Kolegjit të Apelit, nuk do të duhej të merrnin pjesë në shqyrtimin e atij vendimi, nëse shqyrtimi i tillë urdhërohet nga Gjykata Kushtetuese;
- Neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24 është në kundërshtim me nenin 145 të Kushtetutës.

5. Parashtruesi pretendon, në veçanti, që vendimi i Kolegjit të Apelit ka shkelur: nenin 3.2 [Barazia para Ligjit]; nenin 31.1 dhe 2 [E drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave]; nenin 102.2 deri 4 [Dispozitat e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]; nenin 112.2 [Parimet e Përgjithshme]; nenin 116.3 [Efekti Ligjor i Vendimeve]; nenin 143 [Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës]; nenin 145.2 [Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Legjislacionit të Aplikueshëm] të Kushtetutës, si dhe nenin 13 [E Drejta për Ankim

Efektiv] të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

6. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të shqyrtojë nëse vendimi i Kolegjit të Apelit është në përputhje me këto dispozita të Kushtetutës.

Baza juridike

7. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 (1) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

8. Parashtruesi e parashtrori kërkesën në Gjykatë më 23 prill 2010.
9. Kërkesa iu komunikua Dhomës së Posaçme më 3 qershor 2010, e cila ia dorëzoi komentet e veta Gjykatës më 8 korrik 2010. Dhoma e Posaçme deklaroi se “bazat për vendimet e nxjerra janë përcaktuar ekskluzivisht në arsyetimin e tyre ligjor”.
10. Më 28 qershor 2010, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 25/10, e caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 25/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Kadri Kryeziu.
11. Më 2 shkurt 2011, Gjykata i dorëzoi një kërkesë parashtruesit për sqarime dhe dokumente plotësuese, të cilës iu përgjigj më 8 shkurt 2011.
12. Më 18 shkurt 2011, Gjykata i dorëzoi një kërkesë parashtruesit për sqarime të mëtejme, i cili nuk ka dorëzuar asnjë koment deri më tani.
13. Më 3 mars 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, i cili nuk ka dorëzuar asnjë koment.
14. Më 30 mars 2011, Gjykata shqyrtoi dhe votoi lidhur me kërkesën.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 21 maj 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi) miratoi Ligjin Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Ligji për AKP-në). Neni 1 i Ligjit për AKP-në thotë që “Agjencia themelohet si një organ i pavarur publik ...”, dhe “... themelohet si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit’ (në tekstin e mëtejme: AKM) e rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit’ (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12), me ndryshime, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë”. Për më tepër, neni 31 i Ligjit për AKP-në përcakton në paragrafin 1 se Ligji për AKP-në “mbisundon çdo dispozitë tjetër të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të”, ndërsa paragrafi 2 thotë që “Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12, me ndryshimet dhe plotësimet e saj, nuk do të prodhojë efekte juridike pas hyrjes në fuqi të Ligjit për AKP-në”.

16. Më 22 qershor 2009, drejtori i Zyrës për Çështje Ligjore të UNMIK-ut (në tekstin e mëtejme: ZÇL) i dërgoi letër kryetarit të Gjykatës Komunale të Istogut, ku theksonte se, duke pasur parasysh faktin se UNMIK-u do të ishte përgjegjës për administrimin dhe mbikëqyrjen e ndërmarrjeve shoqërore (në tekstin e mëtejme: NSH) dhe të pronës së tyre nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, ZÇL-së i nevojiteshin kopjet e të gjithë urdhrave dhe vendimeve të nxjerra që nga qershori 2008 nga gjykatat relevante të Kosovës, që merren me NSH-të dhe mjetet e tyre.
17. Më 16 tetor 2009, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme nxori vendimin për rastin Nr. SCEL-09-0003, me të cilin e shpalli të pavlefshme listën e punëtorëve legjitimë për të ardhurat nga privatizimi. Trupi gjykues, më pas, pezulloi procedurën në këtë rast dhe udhëzoi ankuesin/të paditurën [AKP] të publikonte një listë të re në përputhje me ligjin.
18. Më 26 tetor 2009, Kryesuesi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme kërkoi nga PSSP-ja të ofronte sqarime për nenin 5.2 (përcakton kategorinë e personave dhe organeve që mund të sillen para Dhomës së Posaçme) të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 mbi themelimin e Dhomës së Posaçme në Gjykatën Supreme të Kosovës mbi çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, të ndryshuar (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut 2008/4), duke pasur parasysh një ligj të miratuar nga Kuvendi për Themelimin e AKP-së, ligji i zbatueshëm në Kosovë, dhe juridiksionin e Dhomës së Posaçme.
19. Sqarimi që Dhoma e Posaçme e kërkoi nga PSSP-ja ka të bëjë me pyetjen nëse AKP-ja mund të trajtohet si "Agjenci", në përputhje me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2008/4.
20. Më 12 nëntor 2009, PSSP i dërgoi Dhomës së Posaçme një sqarim për nenin 5.2 të Rregullores 2008/4, në të cilin thuhet që "Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12, e cila e themeloi AKM-në, mbeti në fuqi dhe zbatohet në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (në tekstin e mëtejme: Rezoluta 1244 e KSKB-së), dhe ajo mund të anulohet apo ndryshohet vetëm nëpërmjet një rregulloreje tjetër të UNMIK-u , gjë që nuk ka ndodhur.
21. Sipas mendimit të PSSP-së, Ligji [për AKP-në]...pa u shpallur nga një rregullore e UNMIK-ut dhe duke pretenduar të ketë hyrë në fuqi me 15 qershor 2008, nuk mund të heqë apo anulojë Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 as ta shuajë ekzistencën ligjore të AKM-së si Agjenci e pavarur me personalitet të plotë juridik. AKP "më së miri mund të konsiderohet të veprojë si agjent i AKM-së duke operuar pa aprovimin dhe autoritetin e AKM-së/UNMIK-ut. PSSP konstatoi më tej se "Ky sqarim është konfirmim i mjaftueshëm se UNMIK-u as në të kaluarën e as në vazhdimësi të Rezolutës 1244 të KSKB-së nuk do ta miratojë asnjë përpjekje të AKP-së për të marrë trashëgiminë apo autoritetin nga AKM-ja", dhe se "çfarëdo mospërfillje për legjislacionin e AKP-së do të parandalonte Dhomën e Posaçme për ta përfshirë AKP-në në procedurat e saj". Megjithatë, sipas PSSP-së, "ndërsa AKP-ja nuk mund të trajtohet se posedon personalitet juridik, AKP-ja ende mund të konsiderohet si person tjetër i nevojshëm për gjykimin e plotë dhe tërësishëm të rastit në përputhje me dispozitën e nenit 5 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2008/4, të ndryshuar". Në të vërtetë, sipas PSSP-së, Dhoma e Posaçme mund ta konsiderojë AKP-në si partneritet të përgjithshëm të përegjistruar të disa personave fizikë sipas ligjit në fuqi, që veprojnë me një interes të përbashkët. PSSP-ja konkludoi se "është e qartë që një numër i personave fizikë i kryejnë punët e AKP-së, dhe bashkëpunojnë në kryerjen e veprimtarive të AKP-së", dhe që "Në mungesë të bazës së duhur juridike të themeluar në përputhje me Rezolutën 1244 (1999) të KSKB-së, për themelimin e AKP-së, kualifikimin e AKP-së".

22. Më 20 nëntor 2009, AKP paraqiti një ankesë kundër vendimit të Dhomës së Posaçme të 16 tetorit 2009, me të cilin e shpalli listën e punëtorëve, të dorëzuar nga AKP, të pavlefshme.
23. Me letrën e 8 janarit 2010, drejtori i ZÇL të UNMIK-ut e informoi kryetarin e Gjykatës Komunale të Suharekës, se përkundër faktit se AKM-ja nuk ka qenë funksionale prej korrikut 2008, AKM-ja ka vazhduar të ekzistojë si person juridik dhe se UNMIK-u ishte përfaqësues i AKM-së për çështjet e AKM-së para Dhomës së Posaçme, duke përfshirë rastet që ishin referuar nga Dhoma e Posaçme tek gjykatat vendore, me të drejtë ankese në Dhomën e Posaçme. Në letër ceket më tej se çfarëdo korrespondence për çështje juridike në të cilat është e përfshirë AKM-ja duhet të adresohet ZÇL-së së UNMIK-ut, dhe se asnjë vendim apo aktgjykim në të cilin AKM-ja është thirrur si palë nuk mund të jetë i formës së prerë, derisa një vendim apo aktgjykim i tillë t'i dërgohet AKM-së, që përfaqësohej nga ZÇL-ja e UNMIK-ut.
24. Më 4 shkurt 2010, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme (i përbërë nga tre gjyqtarë ndërkombëtarë të EULEX-it) refuzoi ankesën e AKP-së të 20 nëntorit 2009, si të pabazuar. Në lidhje me statusin ligjor të AKP-së dhe zbatueshmërinë e Ligjit për AKP-në, Kolegji deklaroi se “Pasi AKM-ja si agjenci që, në përputhje me ligjin në fuqi në Kosovë, do të duhej të ishte agjencia që merret me privatizimin e NSH-ve dhe me shpërndarjen e 20% punëtorëve legjitimë, nuk vepron më në këtë lëmi të përgjegjësive të veta, dhe pasi ankuesi i ka marrë përsipër ato përgjegjësi sipas Ligjit për AKP-në (jo drejtpërdrejtë të zbatueshëm), Dhoma e Posaçme i pranon aktivitetet e AKP-së si çështje të çartë për t'u mundësuar punëtorëve të përfshirë në procesin e privatizimit të kenë qasje efektive në gjykatë në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së”. Kolegji vazhdoi se “Kjo nuk mund dhe nuk do të thotë që Dhoma e Posaçme e pranon Ligjin për AKP-në si ligj të zbatueshëm në Kosovë, por për të siguruar proces të sigurt dhe të drejtë të privatizimit ky “Ligj” për AKP-në duhet të trajtohet si rregullore e brendshme e vlefshme dhe detyruese e organizatës në kuadër të procesit të privatizimit. Paneli konkludoi që “AKP-ja, faktikisht duke vepruar si pasardhëse e AKM-së në fushën e privatizimit, duhet të ndjekë, së paku në këtë kontekst, rregullat e përcaktuara në Ligjin për AKP-në.”

Pretendimet e parashtruesit

25. Parashtruesi i pretendon që Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme ka shkelur të drejtën e AKP-së për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga një gjykatë e pavarur, kur me letrën e 26 tetorit 2009, Kryetari i tij, duke vepruar si Kryetar i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme, kërkoi nga PSSP-ja të ofronte “sqarim për nenin 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 të 5 shkurtit 2008, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 mbi themelimin e Dhomës së Posaçme në Gjykatën Supreme të Kosovës mbi çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, të ndryshuar, duke pasur parasysh një ligj të miratuar nga Kuvendi për Themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ligji i zbatueshëm në Kosovë, dhe juridiksionin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit”.
26. Në këtë drejtim, parashtruesi i referohet, në veçanti, praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, duke përcaktuar që një gjykatë e pavarur është gjykatë e cila në minimum është e pavarur nga ekzekutivi dhe palët. Në rastin Cambell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar (të 28 qershorit 1984, Seria A nr. 84, § 78), GJEDNJ përcakton disa faktorë që duhet pasur parasysh për ta vlerësuar pavarësinë e cilësdo gjykatë:

“Për të përcaktuar nëse një organ mund të konsiderohet i “pavarur” – veçanërisht i ekzekutivit dhe i palëve të rastit (shih, ndër të tjera, Le Compte, Van Leuven dhe De

Meyere, aktgjykim i 23 qershorit 1981, Seria A nr. 43, f. 24, para. 55), Gjykata ka pasur parasysh mënyrën e emërimit të anëtarëve të vet dhe kohëzgjatjen e mandatit të tyre (po aty, f. 24-25, para. 57), ekzistencën e garancive kundër presioneve të jashtme (shih aktgjykimin Piersack të 1 tetorit 1982, Seria A nr. 53, f. 13, para. 27), dhe çështjen nëse organi paraqet pamje të pavarësisë (shih aktgjykimin Delcourt të 17 janarit 1970, Seria A nr. 11, f. 17, para. 31)”.

27. Parashtruesi më tej i referohet aktgjykimit të GJEDNJ, Beaumartin kundër Francës, datuar më 24 nëntor 1994, Seria A nr. 296-B, në të cilën, Conseil d’Etat i Francës ishte i detyruar me ligj të interpretoj një rast para tij në pajtueshmëri me një marrëveshje ndërkombëtare të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme. GJEDNJ deklaroi se kjo është në kundërshtim me pavarësinë e gjyqësorit dhe se marrëveshja ndërkombëtare ia mohon gjykatës juridiksionin e saj të plotë dhe përfundoi se, për këtë arsye, kjo ishte shkelje e nenit 6 të Konventës.
28. Parashtruesi ka bërë referencë të mëtejme lidhur me aktvendimin e GJEDNJ-së, Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, të 25 korrikut 2002, në të cilën GJEDNJ përfundoi se ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës, kur Presidenti i Ukrainës dërgoi dy letra tek gjykatat përkatëse duke kërkuar prej tyre ta “ mbrojnë interesin e shtetasve të Ukrainës” në çështjen mes një kompanie ruse dhe një kompanie ukrainase, ku gjykatat përkatëse dhanë vendime kontradiktore dhe të pazakonshme.
29. Parashtruesi, po ashtu, i referohet edhe aktgjykimit të GJEDNJ, Zielinski, Pradal, Gonzalez dhe të tjerët kundër Francës, të 28 tetorit 1999, §§ 57-57, Raportet 1999-VII, në lidhje me ndërhyrjet legjislative në procesin e vendimmarrjes gjyqësore përmes adoptimit të legjislacionit i cili në të vërtetë ka paracaktuar rezultatin e padisë në fjalë, në mënyrë që të mbrohen interesat shtetërore. GJEDNJ deklaroi se “Gjykata ripohon se derisa në parim legjislatura nuk është përfshirë në çështje civile duke miratuar dispozita të reja retrospektive, për të rregulluar të drejtat që rrjedhin prej ligjeve ekzistuese, parimi i sundimit të ligjit dhe nocioni i gjykimit të ndershëm, i mishëruar në nenin 6, përjashton çdo ndërhyrje nga legjislatura – ndryshe nga arsyet bindëse me interes të përgjithshëm - me administrimin e drejtësisë të dizajnuar për të ndikuar në përcaktimin gjyqësor të një mosmarrëveshje”.
30. Në vështrim të praktikës precedente të GJEDNJ-së, një kërkesë e llojit të tillë që Dhoma e Posaçme i ka shtruar PSSP-së, UNMIK-ut, sipas mendimit të parashtruesit, do të ishte në kundërshtim të plotë me normat e pranuar të praktikës bashkëkohore të gjyqësorit në Evropë.
31. Gjithashtu, parashtruesi pohon se kërkesa e Dhomës së Posaçme për sqarim ka shkelur të drejtat e tij në një proces të pavarur gjyqësor në një gjykatë të pavarur, pasi që PSSP-ja është Kreu i UNMIK-ut dhe autoriteti kryesor ekzekutiv në Kosovë, bazuar në Rezolutën 1244 të KSKB-së, si mund të lexohet në letrën që i kishte dërguar UNMIK-u Dhomës së Posaçme. Për më tepër, letra i është dërguar UNMIK-ut i cili mund të konsiderohet si palë në rastin para Dhomës së Posaçme, pasi që rasti në fjalë ngrit çështjen, nëse AKP-ja është autoritet kompetent si palë para Dhomës së Posaçme, apo Departamenti Ligjor i UNMIK-ut që përfaqëson AKM-në. Si shtesë e kësaj, parashtruesi thekson se në lëshimin e sqarimit, PSSP ka ofruar sqarim të aktit ligjor – Rregullores mbi Dhomën e Posaçme - e cila ishte tërësisht e hartuar nga UNMIK-u dhe shpallur nga PSSP-ja. Prandaj, sa i përket këtij akti ligjor, UNMIK-u dhe PSSP-ja duhet të konsiderohen si ligjvënës dhe “sqarimi” duhet të konsiderohet si një akt shtesë ligjor i kontestuar, përmes të cilit PSSP-ja “sqaron” një çështje që buron nga rregulloret e mëhershme të UNMIK-ut (në këtë rast, Rregulloren mbi Dhomën e Posaçme).

32. Dhoma e Posaçme nuk i ka ofruar AKP-së mundësinë që të përgjigjet në letrën e UNMIK-ut, por në vend të kësaj mori Vendimin (ASC-09-0089), të 4 shkurtit 2010, i cili përsëriti konkluzionet themelore juridike të ofruara në sqarim. E gjithë kjo qartë vërteton njëanshmërinë e Dhomës së Posaçme në favor të UNMIK-ut përballë AKP-së. Në lidhje me këtë, parashtruesi i referohet rastit Vermeulen kundër Belgjikës, në të cilin GJEDNJ-ja vendosi që fakti se ishte e pamundur për kërkuesin që t'i përgjigjet Prokurorit të Përgjithshëm para përfundimit të dëgjimit, përbën shkelje të të drejtave të kërkuesit. "Kjo e drejtë do të thotë në parim, mundësi që palët në gjykim penal apo civil të kenë njohuri dhe të komentojnë dëshmitë apo vëzhgimet e ngritura, madje edhe nga një anëtar i pavarur i shërbimit ligjor kombëtar, me qëllim të ndikimit në vendimin gjykatës. "Rrjedhimisht, GJEDNJ-ja konsideroi se ky fakt në vetvete përmban shkelje të nenit 6 (1) të Konventës.
33. Parashtruesi më tej pohon se, në bazë të nenit 102.3, 112.1 dhe 116.3 të Kushtetutës, Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme, nuk është organ kompetent për të marrë vendim që e shfuqizon Ligjin mbi AKP-në. Për më tepër, sipas Kapitullit VIII [Gjykata Kushtetuese] të Kushtetutës, Gjykata është i vetmi organ në Republikën e Kosovës që mund të shpall një ligj të pafuqishëm. Vendimi i Kolegjit të Ankesave në mënyrë eksplicite refuzon pranimin e Ligjit mbi AKP-në si ligj, duke u referuar në Ligjin mbi AKP-në si "rregulla të detyrueshme të brendshme të organizatës në kuadër të procesit të privatizimit." Në këtë aspekt, vendimi tenton të shfuqizojë statusin e ligjit të Ligjit mbi AKP-në, i cili është plotësisht jashtë autoritetit të Dhomës së Posaçme.
34. Sipas parashtruesit, kur katër (4) gjyqtarët e EULEX-it morën vendimin si anëtarë të Kolegjit të Ankesave, Dhoma e Posaçme ka shkelur nenin 143 dhe 145.2 të Kushtetutës, nenet 3.2 dhe 3.3 të Aneksit VII [Prona dhe Arkivat] të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Propozimi Gjithëpërfshirës), dhe nenit 3.3 të Rregullores së punës të Dhomës së Posaçme. Neni 3.3 i Aneksit VII të Propozimit Gjithëpërfshirës (i cili është në fuqi në bazë të nenit 143 të Kushtetutës) shprehimisht përshkruan se Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme do të ketë tre gjyqtarë ndërkombëtarë. Asnjë dispozitë e Propozimit të Përgjithshëm nuk parasheh autorizim për emërimin e katër gjyqtarëve ndërkombëtarë për Kolegjin e Ankesave.
35. Përveç kësaj, parashtruesi pohon se neni 3.3 i Rregullores së Dhomës së Posaçme parasheh se Kolegji i Ankesave do të përbëhet nga Presidenti i Dhomës së Posaçme, dy gjyqtarë ndërkombëtarë dhe dy gjyqtarë që janë banorë të përhershëm të Kosovës. Asnjë dispozitë e Rregullores mbi Dhomën e Posaçme nuk parasheh autorizim për të emëruar katër gjyqtarë ndërkombëtarë në Kolegjin e Ankesave. Neni 143 i Kushtetutës parasheh se Propozimi Gjithëpërfshirës do të ketë përparësi ndaj Rregullores së Dhomës së Posaçme. prandaj, Propozimi Gjithëpërfshirës në mënyrë të qartë dhe të sigurt parasheh se Kolegji i Ankesave, do të ketë tre gjyqtarë ndërkombëtarë, pastaj se Rregullorja mbi Dhomën e Posaçme duhet të interpretohet në përputhje me Propozimin Gjithëpërfshirës, dhe se nuk mund të interpretohet si të lejonte emërimin e katër gjyqtarëve ndërkombëtarë në Kolegjin e Ankesave.
36. Më 23 prill 2010, parashtruesi paraqiti kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar nga Gjykata për të anuluar vendimin Dhomës së Posaçme, në këtë mënyrë duke kërkuar nga Dhoma e Posaçme të shqyrtojë vendimin e vet në baza të drejta dhe të paanshme, si dhe në pajtueshmëri me Kushtetutën.
37. Gjithashtu, parashtruesi kërkon që, nëse Gjykata vendos ta anulojë vendimin e mëhershëm të Dhomës së Posaçme, siç specifikohet me nenet 31.2, 53, 102.2, 102.4 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ, gjyqtarët e EULEX-it që vendosen në rastin përkatës nuk do të duhej të merrnin pjesë në shqyrtimin e atij vendimi.

Vlerësimi për pranueshmërinë e Kërkesës

38. Në mënyrë që të jetë në gjendje të vendos për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë paraprakisht nëse parashtruesi ka përmbushur të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
39. Gjykata së pari duhet të përcaktojë nëse parashtruesi është palë e autorizuar, që posedon personalitet juridik brenda kuptimit të nenit 21.4 të Kushtetutës, duke deklaruar “Të drejtat dhe liritë themelore të parapara me Kushtetutë vlejné edhe për personat juridik për aq sa janë të zbatueshme”. Në këtë aspekt, referimi i është bërë nenit 1 të Ligjit mbi AKP-në, ku parashihet: “Agjencia do të posedoj personalitet të plotë juridik”. Prandaj, parashtruesi është palë e autorizuar, me të drejtë të ngrejë këtë rast para Gjykatës sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.
40. Gjithashtu, sipas kriterëve që parashtruesi duhet të paraqes kërkesën brenda 4 muajve pasi që gjykata të ketë marrë vendimin përfundimtar për rastin, Gjykata përcakton që Kolegji i Kërkesave i Dhomës së Posaçme mori Vendimin ASC-09-089 më 4 shkurt 2010, ndërsa parashtruesi pranoi vendimin më 10 shkurt 2010. Parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 23 prill 2010. Prandaj, parashtruesi ka përmbushur afatin e nevojshëm për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë, të paraparë me nenin 49 të Ligjit.
41. Gjykata, po ashtu, përcakton se parashtruesi ka shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore. Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme konsiderohet si “instanca e fundit gjyqësore për të gjykuar çështjet lidhur me privatizimin” sipas Dhomës së Posaçme, përmes një letre të dërguar Gjykatës me 8 korrik 2010. Si rezultat, parashtruesi ka shteruar të gjitha mjetet ligjore që ceken në nenin 47.2 të Ligjit.
42. Gjithashtu, Gjykata përcakton se parashtruesi ka plotësuar nenin 48 të Ligjit: “Në Kërkesën e tij/saj, paraqitësi i kërkesës duhet të sqarojë qartë se cilat të drejta dhe liri ai/ajo pretendon t’i jenë shkelur dhe cili akt konkret i autoritetit publik është lëndë e kontestueshme”.
43. Pasi që parashtruesi është palë e autorizuar, ka përmbushur afatet e nevojshme që të paraqes kërkesën në Gjykatë, ka shteruar të gjitha mjetet ligjore, dhe sqaruar me përpikëri pohimet e shkeljes së të drejtave dhe lirive, përfshirë vendimin e lëndës së kontestuar, Gjykata përcakton se parashtruesi ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri.

Vlerësimi ligjor i Kërkesës

44. Derisa parashtruesi ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri, Gjykata duhet të shqyrtojë themelësinë e ankesës së parashtruesit.

1. Sa i përket statusit ligjor të parashtruesit

45. Parashtruesi pohon se Kolegji i Ankesave të Dhomës së Posaçme ka shkelur të drejtën e AKP-së në një dëgjim publik të drejtë dhe të paanshëm, nga ana e një trupit të pavarur dhe të paanshëm duke kërkuar nga UNMIK-u që të ofrojë një sqarim për interpretim të ligjit në fuqi dhe, në veçanti, të nenit 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 (për ndryshimin e Rregullores 2002/13 mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme), duke ofruar një listë gjithëpërfshirëse të palëve që kualifikohen si paditëse në procedure në Dhomën e Posaçme. Sipas mendimit të parashtruesit, një kërkesë e tillë është në kundërshtim me nenet 31.2 [Të drejtën në Gjykim të Ndershëm dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimin e Dispozitave të Drejtave Njerëzore], 102 (2) dhe (4) [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.

46. Gjykata vëren se, sipas sqarimit që e paraqiti PSSP-ja më 12 nëntor 2009 tek Presidenti i Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme, “qëndrimi i përgjithshëm i UNMIK-ut karshi AKP-së është i njohur dhe është sjellë në vëmendje të Dhomës së Posaçme në raste të ndryshme të shqyrtuar nga kjo Dhomë ...Edhe nëse merret parasysh kuptimi ligjor sipas vetë AKP-së, njohja e legjislacionit të Kuvendit të Kosovës si bazë ligjore, që nënkupton themelimin e AKP-së, tregohet i pasuksesshëm. Legjislacioni i AKP-së shkel të drejtat themelore nga të cilat synon të pranojë legjitimitet: Aneksi VII, neni 2.1 i propozimit të Ahtisarit”. Sqarimi, për më tepër, përmend se “AKP nuk është themeluar në bazë të ligjit në fuqi në Kosovë” dhe në pajtim me rezolutën 1244 (1999) të KSKB-së dhe nuk mund të trajtohet në mënyrë ligjore si pasardhës i ligjshëm i AKM-së ...”, dhe se “AKP-së nuk mund t’i akordohet statusi i personit juridik” si dhe “...diskrecioni i Dhomës së Posaçme për ta quajtur AKP-në me zotësinë e saj si person jo-juridik...”.
47. Sa i përket pyetjes nëse Kolegji i Ankesave ka marrë parasysh sqarimin e UNMIK-ut në Vendimin e vet ASC-09-089, siç pretendohet nga parashtruesi, Gjykata vëren se interpretimi i ofruar nga sqarimi i UNMIK-ut qartazi reflektohet në vendimin e Kolegjit, p.sh. kur thekson se “pranon aktivitetet e AKP-së si çështje fakti të qarta” dhe “... Ligji mbi AKP-në..., sipas të cilit AKP-ja është themeluar si institut faktik...”. Kolegji i Ankesave, për më tepër, pohon se “kjo nuk do të thotë se, Dhoma e Posaçme e Posaçme pranon Ligjin e AKP-së si ligj të aplikueshëm në Kosovë, por, për të siguruar një proces të sigurt dhe të drejtë të privatizimit, ky ligj i AKP-së duhet të trajtohet si rregulla të vlefshme dhe detyruese brenda organizatës, në kuadër të procesit të privatizimit”.
48. Prandaj, sipas vështrimit të Gjykatës, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, duke kërkuar sqarim nga PSSP i UNMIK-ut, që nuk iu kishte komunikuar parashtruesit në mënyrë që ta lejoj atë që ta shpreh mendimin lidhur me “Sqarimin”, por në të vërtetë është përdor nga Dhoma e Posaçme në tekstin e vendimit ASC-09-089, nuk mund të konsiderohet si grup gjykues i paanshëm, ndaj të cilit parashtruesi gëzonte të drejta, sipas nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe neni 6 [E Drejta në Gjykim të Drejtë] të KEDNJ-së.
49. Rrjedhimisht, Dhoma e Posaçme me veprimet e saj ka cenuar nenet e sipërpërmendura.
50. Në Vendimin e vet ASC-09-089, Kolegji i Ankesave, siç u përmend më lart, gjithashtu shqyrtoi statusin ligjor të AKP-së, edhe pse në fund të fundit, gjykoi se AKP-ja ishte vetëm organizatë faktike, edhe përkundër faktit se, në pajtim me nenin 5 [Themelimi dhe Statusi Ligjor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit] të Ligjit 03/L-067, AKP-ja “është themeluar si një organ publik i pavarur, ...do të posedojë zotësi të plotë juridike ...[dhe] është themeluar si pasardhës i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 “Mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, e ndryshuar.
51. Në lidhje me këtë Gjykata mban qëndrim se, një nga aspektet e gjykimit të drejtë është se pala duhet të ketë të drejtë për pjesëmarrje efektive në procedurat gjyqësore, që do të thotë se, në rastin konkret, parashtruesi duhej të ishte palë në procedurë “në emër të tij”, si Agjencia Kosovare e Privatizimit”, në pajtim me Ligjin 03/L-067, dhe jo siç përcaktohet nga Dhoma e Posaçme në Vendimin e saj ASC-09-0089, “...si organizatë faktike..”.
52. Gjykata konsideron se mosnjohja e statusit ligjor të parashtruesit si palë në procedurë, siç është parashtruar në nenin 5 të Ligjit 03/L-067, Dhoma e Posaçme i ka cenuar parimet e gjykimit të drejtë siç garantohen në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
53. Në këto rrethana, Gjykata vetëm mund të vijë në përfundim se Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk njeh dhe zbaton ligjet e

miratuara ligjërisht nga Kuvendi. Në fakt, Dhoma e Posaçme thjeshtë vazhdon ta injoroi ekzistimin e Kosovës si shtet të pavarur dhe ligjet që burojnë nga Kuvendi i saj.

54. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet Opinioni Këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të 22 korrikut 2010, sipas të cilit miratimi i shpalljes së pavarësisë, më 17 shkurt 2008, nuk ka shkelur ligjin e përgjithshëm ndërkombëtar, Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) apo Kornizën Kushtetuese. Sipas mendimit të Gjykatës, themelimi i Republikës së Kosovës si shtet i pavarur, sipas deklaratës së pavarësisë dhe shtetësia e së cilës ishte njohur, deri më tani, nga 75 shtete, prandaj nuk është në kundërshtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244(1999) si dhe të drejtën ndërkombëtare, parimeve që duhet t'iu përmbahet Republika e Kosovës, siç është parashtruar në nenin 16 (3) të Kushtetutës, që përcakton se “Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare”.
55. Neni 7 [Vlerat] i Kushtetutës, që hyri në fuqi më 16 qershor 2009, përcakton disa nga këto parime, si vijon: “Rendi Kushtetues i Republikës së Kosovës është i bazuar në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive njerëzore dhe sundimit të ligjit, jo-diskriminimit, të drejtës në pronë, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut”.
56. Si pjesë e parimit të Sundimit të Ligjit, neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], paragrafi 3 i Kushtetutës përcakton se “Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”, që do të thotë se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, si pjesë e Gjyqësorit të Kosovës, ka obligim kushtetues të zbatoj ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës.
57. Për më tepër, Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, dispozitat e të cilit do të kenë përparësi ndaj të gjitha dispozitave ligjore në Kosovë, në Aneksin IV [Sistemi i Drejtësisë], neni 1.1, qartazi përcakton se “Gjykata Supreme do të sigurojë zbatim të njëtrajtshëm të ligjit duke vendosur mbi ankesat në përputhshmëri me ligjin”. Prandaj, Dhoma e Posaçme, si pjesë e Gjykatës Supreme është e obliguar ta respektojë këtë dispozitë.
58. Përfundimisht, neni 145 [Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm] përcakton se “Legjislacioni i aplikueshëm në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute vazhdon të zbatohet për aq sa të jetë në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet ose amendamentohet në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë”. Si interpretues përfundimtar i Kushtetutës, Gjykata konsideron se legjislacioni i zbatueshëm në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute përfshinë rregulloret e UNMIK-ut dhe vendimet administrative të nxjerra nga PSSP-ja para 15 qershorit 2008. Në pajtim me nenin 145, rregulloret dhe udhëzimet administrative të tilla, si dhe legjislacioni tjetër do të vazhdojnë të zbatohen vetëm për aq sa janë në pajtim me Kushtetutën derisa të shfuqizohen, zëvendësohen apo ndryshohen në pajtim me Kushtetutën.
59. Rrjedhimisht, Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12, e ndryshuar, që u shfuqizua me nenin 31 [Ligji i Zbatueshëm] të Ligjit Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit të 21 majit 2008, që thotë: “Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12, e ndryshuar, nuk do të ketë efekt ligjor që nga data që hyn në fuqi ligji i tanishëm” nuk është më i zbatueshëm. Prandaj, rregulloret e UNMIK-ut dhe udhëzimet administrative relevante vazhdojnë të jenë të zbatueshme vetëm për aq sa janë në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 03/L-067.
60. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, në vendimin e saj ASC-09-089, qartazi “nuk ka siguruar zbatimin e njëtrajtshëm të Ligjit”, siç parashihet me Propozimin Gjithëpërfshirës, gjithashtu nuk ka vepruar në pajtim me obligimet e parapara në nenin e lartpërmendur 102 të Kushtetutës, pasi që nuk e ka

zbatuar Ligjin 03/L-067. Përkundrazi, Ligjin Nr. 03/L-067 nuk e ka konsideruar si ligj, drejtësisht i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, por si rregulla të brendshme të vlefshme dhe të detyrueshme të organizatës së AKP-së, që e karakterizoi si organizatë faktike, në vend të një organi publik të pavarur me zotësi të plotë juridike, siç është parashtruar në Ligjin Nr. 03/L-067.

61. Konstatimi se Dhoma e Posaçme nuk siguron zbatim të njëtrajtshëm të ligjit, edhe më tepër, ilustron me faktin se baza e statusit ligjor të gjyqtarëve të EULEX-it në Dhomën e Posaçme rregullohet me Ligjin Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, sipas rregullit miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 13 mars 2008, dhe, siç vëren Gjykata, efektivisht i zbatuar nga EULEX-i në Kosovë si ligj i Kuvendit. Ky Ligj në nenin e tij 1 [Qëllimi], rregullon integrimin dhe juridiksionin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në sistemin Gjyqësor dhe Prokurorial të Republikës së Kosovës. Gjykata e konsideron si të paimagjineshme se gjyqtarët e EULEX-it të integruar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në pajtim me Ligjin 03/L-053 – refuzojnë të zbatojnë ligjet e miratuara sipas rregullit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
62. Rrjedhimisht, duke mos zbatuar Ligjin 03/L-067 për AKP-në, sipas rregullit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, Dhoma e Posaçme me veprimet e saj ka cenuar nenin 102 të Kushtetutës.

2. Sa i përket ankesës së parashtruesit lidhur me përbërjen e Kolegjit të Ankesave

63. Për më tepër, parashtruesi ankohet se nenet 31.2 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe Propozimi Gjithëpërfshirës, dhe Rregullorja e punës së Dhomës së Posaçme, ishin shkelur, pasi që Kolegji i Ankesave që u morr me lëndën në fjalë, ishte përbërë nga katër (4) gjyqtarë të EULEX-it.
64. Nga vendimi i Kolegjit të Ankesave, duket se ishin tre (3) dhe jo katër (4) gjyqtarë të EULEX-it gjatë procedurave para Kolegjit të Ankesave. Njëri prej gjyqtarëve, i përmendur nga parashtruesi, megjithatë është, ofiqar i EULEX-it dhe jo gjyqtar i EULEX-it.
65. Gjithashtu, duhet të përcaktohet nëse mungesa e dy (2) gjyqtarëve kosovar në Kolegjin e Ankesave, siç specifikohet në nenin 3.3 të Sektorit VII të Propozimit Gjithëpërfshirës, përbën shkelje të nenit 31.2 dhe 54 të Kushtetutës, siç pretendon parashtruesi.
66. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se pjesëmarrja e gjykatësve kosovar në vendimet e Kolegjit të Ankesave, me sa duket nuk është kusht i nevojshëm për funksionimin e Kolegjit.
67. Sipas nenit 14 të Urdhëresës Administrative Nr. 2008/6, ndër të tjera, duke siguruar rregullat mbi përbërjen e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, kërkohet një kuorum prej tre gjyqtarëve që të vendos për rastin që paraqitet para tij. Sidoqoftë, Urdhëresa hesht lidhur me pyetjen nëse kuorumi i gjyqtarëve duhet të përmbajë numër të caktuar të gjyqtarëve të EULEX-it dhe gjyqtarëve kosovar. Rrjedhimisht, prezenca e tre (3) gjyqtarëve të Kolegjit të Ankesave nuk ka shkelur ndonjë nen të Kushtetutës apo të Propozimit Gjithëpërfshirës.
68. Prandaj, sipas ankesës së parashtruesit lidhur me mungesën e gjyqtarëve kosovar në Kolegjin e Ankesave, kur u mor Vendimi ASC-09-089, Gjykata nuk konstaton shkelje të neneve 31.2 dhe 54 të Kushtetutës, në të cilat është thirrur parashtruesi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullit 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 30 mars 2011, njëzëri, vendos që ta

- I. SHPALL Kërkesën të PRANUESHME;
- II. SHPALL të pavlefshëm Vendimin ASC-09-089 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, të 4 shkurtit 2010, që shkel nenet 31 dhe 102 të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të KEDNJ-së;
- III. KTHEJ Vendimin ASC-09-089 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, të 4 shkurtit 2010, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për shqyrtim në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës, sipas nenit 74 (1) të Rregullores së punës; dhe
- IV. Në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme do ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për të zbatuar këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese.

Ky Aktgjykim do t'u njoftohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Ky Aktgjykim do të ketë efekt të menjëhershëm.

Gjyqtarja Raportuese

Gjyljeta Mushkolaj



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani